

UDHËZIM
Nr. 14, datë 10.5.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 44, DATË 21.8.2013 “PËR PËRCAKTIMIN
E KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE TË NJËVLERSHMËRISË SË DËFTESAVE DHE DIPLOMAVE
TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË ARDHUR NGA JASHTË
VENDIT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, pika 2, germa “a” dhe të pikës 4 të nenit 52 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Kreu 3 i udhëzimit të MASH-it nr. 44, datë 21.8.2013, “*Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit*”, ndryshon si vijon:

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) kryen procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave/ diplomave të arsimit të mesëm të lartë për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit, për vijimin e studimeve në arsimin e lartë dhe për punësimin.

2. Njëvlershmëria e dokumentacionit, për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit që duan të ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në Republikën e Shqipërisë dhe atyre për punësim, bëhet gjatë gjithë vitit.

3. Njëvlershmëria e dëftesave/diplomave të arsimit të mesëm të lartë për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit, për Maturën Shtetërore dhe për punësimin, realizohet nga Komisioni i Posaçëm, i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

4. Nxënësit e ardhur nga jashtë vendit, të cilët duan të vijnë në studimet në IAL-të në vendin tonë, duhet të dërgojnë në rrugë postare ose të dorëzojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, dokumentet si më poshtë:

- a) Formulari i aplikimit për njëvlershmëri (shtojca 2), bashkëlidhur këtij udhëzimi.
- b) Fotokopja e dokumentit të identifikimit të aplikantit.
- c) Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dëftesave të të gjitha viteve të shkollimit dhe diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit ose, në mungesë të dëftesave, kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e listës së notave të arsimit të mesëm të lartë.
- d) Kopje e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dokumentit që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Dokumentet e paraqitura për njëvlershmëri të kenë vulën apostile të shtetit nga vijnë.

5. Dokumentacioni për njëvlershmërinë për punësim në Republikën e Shqipërisë, dorëzohet ose dërgohet përmes shërbimit postar në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, nga aplikanti ose nga institucioni i interesuar punëdhënës.

6. Dokumentet për njëvlershmërinë për punësim, janë:

- a) Formulari i aplikimit për njëvlershmëri (shtojca 3), bashkëlidhur këtij udhëzimi.
- b) Fotokopja e dokumentit të identifikimit të aplikantit.
- c) Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë.

Dokumentet e paraqitura për njëvlershmëri të kenë vulën apostile të shtetit nga vijnë.

7. Dokumentet e dorëzuara për njëvlershmëri, për rastet e përcaktuara në pikat 4 dhe 6 të këtij udhëzimi, shqyrtohen nga Sekretariati Teknik i Komisionit të Posaçëm.

8. Sekretariati Teknik i Komisionit të Posaçëm, paraqet për vendimmarrje në Komisionin e Posaçëm vetëm dokumentet/ aplikimet për njëvlershmëri, që rezultojnë të plotësuara sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 4 dhe 6 të këtij udhëzimi. Kur Sekretariati vëren mangësi në dokumente/aplikim, i kthen përgjigje me shkrim aplikantit, duke specifikuar arsyet pse nuk i njëvlerësohet dokumenti i shkollimit.

9. Komisioni i Posaçëm, për nxënësin e ardhur nga jashtë vendit që do të ndjekë studimet në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në vendin tonë, brenda 5 (pesë) ditëve shqyrton dhe harton dokumentin e njëvlershmërisë, në të cilin përcaktohet:

- a) Indeksi i shkollës së kryer.
- b) Nota mesatare për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë, e njëvlerësuar.
- c) Notat e njëvlerësuar me provimet e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
- d) Nota mesatare e përgjithshme, e njëvlerësuar.

10. Njëvlershmëria e rezultateve të arritura në shtetin përkatës të kryhet në përputhje me tabelën bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi (shtojca 1).

11. Komisioni i Posaçëm njëvlerëson lëndën, e cila përcakton njohuritë gjuhësore dhe letrare të shtetit nga vjen nxënësi, me lëndën/lëndët “Gjuhë shqipe dhe letërsi”.

12. QSHA-ja, mbështetur në vendimin e Komisionit të Posaçëm, pajis nxënësin e ardhur nga jashtë vendit me dokumentin e njëvlershmërisë. Ky dokument miratohet/nënshkruhet nga drejtuesi i QSHA-së dhe lëshohet në dy kopje origjinale.

II. Pika III *“Dispozita të përgjithshme”* e kreut 3, të udhëzimit nr. 44, datë 21.8.2013, *“Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftësve dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”*, shfuqizohet.

III. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA 1
TABELA E KONVERTIMIT TË NOTAVE

Shteti	Klasat	Notat						
Shqipëri	1 - 12	4	5	6	7	8	9	10
Greqi	1 - 4	4.00 - 4.90	5.00 - 6.49			6.50-8.49		8.50-10.00
	5 - 6		5	6	7	8	9	10
	7 - 12	7-9	10	11-12	13-14	15-16	17-18	19-20
Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Slloveni	1 - 5	1	2		3	4		5
	6 - 9	1	2		3	4		5
	10 - 12	1	2.00-2.99		3.00-3.99		4.00-4.99	5.00
Itali	1 - 13	5.99	6.00-6.99		7	8	9	10
Turqi	1 - 12	25.44	45-54		55-69		70-84	85-100
	1 - 12	1	2.00-2.99		3.00-3.99		4.00-4.99	5
Gjermani Austri	1 - 10	6.00	5.00	4.00	3.00		2.00	1.00
	11 - 13	6.00	5.00	4.00	3.00		2.00	1.00
SHBA, Mbretëri e Bashkuar	1 - 9	F	D		C		B	A
	10 - 12	F	D		C		B	A
	%	34	35-37		38-49		50-63	64-100
Bullgari	1 - 9	2.00-2.99	3.00-3.99		4.00-4.99		5.00-5.99	6.00
	10 - 12	2.00-2.99	3.00-3.99		4.00-4.99		5.00-5.99	6.00
Poloni	1 - 9	1	2		3		4	5-6
	10 - 12	1	2		3		4	5-6
Rumani	1 - 12	4	5	6	7	8	9	10
Francë	1 - 12	-7.99	8.00-9.99	10.00-11.99	12.00-13.99	14.00-15.99	16.00-17.99	18.00-20.00
Belgjikë (flemish)	1 - 12	-7.99	8.00-9.99	10.00-11.99	12.00-13.99	14.00-15.99	16.00-17.99	18.00-20.00
Belgjikë (french)	1 - 12	-9.99	10-11.99	11-12.99	13-15.99	16-17.99	18-19.99	20
Luksemburg	1 - 12	-19.99	20-29.99	30-39.99		40-49.99		50-60

Zvicër	1 - 12	-3.99	4-4.49		4.50-4.99		5-5.49	5.50-6
Norvegji	1 - 12	1	2		3		4	5-6
Holandë	1 - 12	4-5.49	5.50-5.99	6-6.49	6.50-7.49	7.50-8.49	8.50-9.49	9.50-10
Finlandë	1 - 12	4-4.99	5	6	7	8	9	10
Spanjë	1 - 12	4	5	6	7	8	9	10
Danimarkë	1 - 12	-1.99	2-3.99	4-6.99		7-9.99		10-12
Egjipt	1 - 12	0-49%	50-64%		65-74%		75-100%	

Shënime.

1. Konvertimi i notave bëhet në mënyrë të përshkallëzuar, duke krahasuar sistemin e vlerësimit në shtetin që ka lëshuar dokumentin shkollor me sistemin e vlerësimit në Republikën e Shqipërisë.

2. Shembull ilustrues 1: nëse në dokumentin shkollor të lëshuar në Francë, vlerësimi në një lëndë është 15.00 nota sipas sistemit tonë del 8.50; nëse nota nga Franca do të ishte 14.75, nota sipas sistemit tonë do të jetë 8.37.

3. Shembull ilustrues 2: nota 4 e Kosovës, sipas sistemit tonë del 8.00; nota 4.7, po e Kosovës, sipas sistemit tonë del 9.40.

4. Për shtete të tjera që nuk pasqyrohen në këtë tabelë, konvertimi bëhet me sistemin më të përafërt, duke shkarkuar sistemin e vlerësimit të shtetit përkatës nga faqet zyrtare në internet.

SHTOJCA 2

KËRKESE APLIKIMI

PËR NJËSIM DIPLOME TË SHKOLLËS SË MESME
(Për vazhdim studimesh në institucionet e arsimit të lartë)

Drejtuar: Qendrës së Shërbimeve Arsimore

TIRANË

Të dhënat e aplikantit:

Emër: _____
Atësi: _____
Mbiemër: _____
Adresa: _____
Telefon: _____

Në vitin shkollor _____, kam mbaruar në (shtetin) _____
shkollën e mesme (përcakto profilin) _____.

Dokumentet që duhen dorëzuar në QShA:

1. Formulari i aplikimit për njëvlershmëri.
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të aplikantit.
3. Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dëftesave të të gjitha viteve të shkollimit dhe diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit ose, në mungesë të dëftesave, kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e listës së notave të arsimit të mesëm të lartë.
4. Kopje e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dokumentit që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
Dokumentet e paraqitura për njëvlershmëri të kenë vulën apostile të shtetit nga vijnë.

Afatet e dorëzimit të dokumenteve:

Gjatë gjithë vitit

Bashkëlidhur kësaj kërkesë gjeni dokumentet si më poshtë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____

Shënim. Aplikanti nuk paguan asnjë lloj tarife për procesin/shërbimin e njëvlershmërisë.

SHTOJCA 3

KËRKESË APLIKIMI

**PËR NJËSIM DIPLOME TË SHKOLLËS SË MESME
(Për punësim)**

Drejtuar: Qendrës së Shërbimeve Arsimore

TIRANË

Të dhënat e aplikantit:

Emër: _____

Atësi: _____

Mbiemër: _____

Adresa: _____

Telefon: _____

Në vitin shkollor _____, kam mbaruar në (shtetin) _____
shkollën e mesme (përcakto profilin) _____ .

Dokumentet që duhen dorëzuar në QSHA:

1. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të aplikantit.
2. Fotokopje e përkthyer dhe e noterizuar e diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit.
3. Dokumentet e paraqitura për njëvlershmëri të kenë vulën apostile të shtetit nga vijnë.

Afatet e dorëzimit të dokumenteve:

Gjatë gjithë vitit

Bashkëlidhur kësaj kërkesë gjeni dokumentet si më poshtë:

1. _____
2. _____
3. _____

Shënim. Aplikanti nuk paguan asnjë lloj tarife për procesin/shërbimin e njëvlershmërisë